



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 qershor 2014
Nr. ref.:RK661/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI33/14

Parashtrues

Kamer Hajdini

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 111/2013, të 24 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Kamer Hajdini, i cili aktualisht është duke e vuajtur dënimin me burgim në Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë, Komuna e Vushtrrisë. Parashtruesi i kërkesës e ka autorizuar djalin e tij, z. Avni Hajdini, që ta përfaqësojë atë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 111/2013, të 24 shtatorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 21 tetor 2013, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 248/2012, të 3 shtatorit 2012, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 1327/12, të 3 prillit 2013, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ED. nr. 201/13, të 25 qershorit 2013, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, P. nr. 568/13, të 20 gushtit 2013, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, P. nr. 16/2014, i 21 janarit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve dhe aktvendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, të cilat pretendohen të kenë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa) dhe me nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, nenin 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 54 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 21 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 27 shkurt 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës, Gjykatën e Apelit të Kosovës dhe Prokurorin e Shtetit për kërkesën.
7. Më 28 shkurt 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI33/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI33/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 31 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 5 mars 2012, Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë ngriti Aktakuzën (PP. nr. 565-1/2009), në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kundër parashtruesit të kërkesës me akuzë se kishte kryer veprat penale të vrasjes në tentativë dhe mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim i armëve, siç parashihen me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK).
10. Më 20 prill 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin KA. nr. 205/12, e vërtetoi aktakuzën e Prokurorit Publik, të ngritur kundër parashtruesit të kërkesës.
11. Më 3 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin P. nr. 248/2012, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprave penale të vrasjes në tentativë dhe mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim i armëve nga neni 146 në lidhje me nenin 20 dhe nenin 328 paragrafi 2 i KPPK-ë. Gjykata e Qarkut në Prishtinë ia shqiptoi parashtruesit të kërkesës dënimin me burgim prej 2 (dy) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj, të cilin parashtruesi do ta vuajë pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.
12. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata e Qarkut në Prishtinë arsyetoi:

“Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, me aktakuzën PP. nr. 956-10/11 të dt.05.03.2012, e ka akuzuar Kamer Hajdinin (parashtruesi i kërkesës), për veprë penale, të vrasjes në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, si dhe për veprën tjetër penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së. Lidhur me këtë qështje penale gjykata përfundoi seancën e shqyrtimit gjyqësore kryesore me dt.03.09.2012, gjate së cilës fillimishtnë ka dëgjuar të dëmtuarin L. G., dëshmitaret D. H.,e R. M.. Gjithashtu ka lexuar edhe shkresa të tjera të propozuara për tu administruar si prova gjat shqyrtimit gjyqësore si:Leximin e raportit mbi shilimin e vendit të ngjarjes të dt.16.12.2011; Shikimin e skicës së vendit të ngjarjes; Shikimi i fotodokumentacionit; Raporti i ekspertizës nga Laboratori i Policisë së Kosovës,i dt.26.01.2012;Raporti i ekspertit mjekoligjore i dt.17.02.2012 me fletëlëshim dhe epikrizë;Vërtetimi mbi konfiskimin e armës dhe municionit, si dhe janë shiquar edhe shkresat e tjera te lendes.,krejt këto me qëllim të gjetjes së të vërtetës.

... Gjykata bëri vlerësimin e të gjitha deklaratave dhe provave të tjera një nga një, duke analizuar të gjitha me vëmendje dhe pas deklaratës së të dëmtuarit pasi mori dhe analizoj me kujdes deklaratën e dëshmitarëve të propozuar nga ana e akuzatorit, u pa se përveq deklaratës së tyre, edhe deklarata e të pandehurit (parashtruesit të kërkesës) ishte e drejtë, si e tillë e besueshme dhe deri diku edhe bindëse edhe për gjykatën, duke pasur parasyshtë të kaluarën e palëve në këte rast të pandehurit me ish dhëndërin e tijl, tani të dëmtuarit LG, të cilët siq shihet edhe nga deklaratat e tyre, kishin pasur raporte tejet të acaruara mes vete, sidomos pas ndarjes së tani të dëmtuarit LG dhe ish bashkëshorten e tijë DH. Kjo u vërtetua edhe gjat shqyrtimit gjyqësorë.

... Gjykata megjithatë, duke analizuar me kujdes veprimet e të pandehurit, gjeti se i njëjti e ka dashur kryerjen e veprës me të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtorë.

... Nga të gjitha këto që u than si më lartë gjykata me pamëdyshje në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe sipas bindjes së lirë e vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitat e aktakuzës, duke vërtetuar kështu se i akuzuari Kamer Hajdini, është penalisht përgjegjës për veprat si në dispozitivat e këtij aktgjykimi, se në veprimet e tij ekzistojnë elementet e veprave penale të përshkruara si në dispozitivat e këtij aktgjykimi, dhe se me veprimet e tij në tërësi është plotësuar figura e veprave penale me të cilat është akuzuar, prandaj edhe e shpalli fajtorë, pasi që më parë gjeti se i njëjti në kohën e kryerjes së veprave penale ishte penalisht i përgjegjshëm dhe për këto vepra penale e dënoi me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim i njëjti do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e kuptohet duke ju llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 16.12.2011 deri më 04.09.2011 në kohën e vuajtjes së dënimit”.

13. Më 4 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin P. nr. 248/2012, e liroi parashtruesin kërkesës nga paraburgimi, deri sa Aktgjykimi P. nr. 248/2012, i gjykatës së njëjtë, i 3 shtatorit 2012, të bëhet i plotfuqishëm.
14. Në një datë të pacaktuar, Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë dhe pala e dëmtuar, L. G., paraqitën ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës, duke kërkuar dënim më të ashpër për parashtruesin e kërkesës.
15. Më 3 prill 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin PAKR. nr. 1327/12, e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 248/2012 dhe i refuzoi ankesat e Prokurorit Publik të Qarkut dhe të palës së dëmtuar, L. G., si të pabazuara.
16. Më 20 maj 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër aktgjykimeve P. nr. 248/2012 dhe PAKR. nr. 1327/12, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, përkatësisht të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Parashtruesi paraqiti gjithashtu kërkesë për shtyrjen e përmbarimit të dënimit me burgim.
17. Më 27 maj 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar rishikimin e procedurës penale, P. nr. 248/2012, dhe duke propozuar shtyrjen e përmbarimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 248/2012.
18. Më 25 qershor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin ED. nr. 201/13, e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e fillimit të vuajtjes së dënimit me burgim.
19. Më 9 korrik 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin Kp. nr. 240/13, refuzoi kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale

kundër Aktgjykimit P. nr. 248/2012, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, si të pabazuar.

20. Më 20 gusht 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin PN. nr. 568/13, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit ED. nr. 201/13, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si të pabazuar.
21. Më 26 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës ishte dërguar në vuajtje të dënimit me burgim.
22. Më 24 shtator 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pml. nr. 111/2013, e refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit P. nr. 248/2012 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 3 shtatorit 2012, dhe të Aktgjykimit PAKR. nr. 1327/2012, Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 3 prillit 2013, si të pabazuar.
23. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës arsyetoi:

“Në kërkesë pretendohet se shkeljet të cilat e arsyetojnë bazueshmërinë e kërkesës janë: falsifikimi i procesverbalit (nuk ceket se cilit) nga kryetari i trupit gjykues, ndalimi-mos dhënia e procesverbaleve avokatit në fazën e ankimimit, mos vendosja për kërkesën për përjashtimin e kryetarit dhe anëtarëve të trupit gjykues dhe refuzimi i propozimeve të tij që janë bërë gjatë procedurës së shkallës së parë për nxjerrjen e provave, që ka ndikuar në vërtetimin e gabuar të fakteve relevante të çështjes penale. Propozimet për nxjerrjen e provave të cilat theksohen në kërkesë janë shikimi i vendit të ngjarjes, dëgjimi i ekspertit mjeko ligjor por edhe ekspertëve të profileve tjera (p.sh. të kirurgjisë torakale), administrimi si provë i raportit të policisë, leximi i SMS të dërguara nga LG në telefonin e DH etj

Këtë pretendim Gjykata Supreme e vlerësojë si të pabazuar. Fakti se kryetari i trupit gjykues ka bërë falsifikim ose ka keqpërdorur funksionin e vet me mos dhënie në shikim të procesverbaleve, do të mund të jenë bazë për rishikimin e procedurës penale, nëse janë plotësuar edhe kushtet tjera për këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik por nuk janë bazë për kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Kërkesa për përjashtimin e kryetarit dhe anëtarëve të trupit gjykues është bërë në fjalën përfundimtare të mbrojtësit të dënuarit, ndërsa konform nenit 42. par. 2 të KPPK që në atë kohë ka qenë fuqi (tani neni 41. par. 2. të KPPK) kërkesa për përjashtimin e gjyqtari ose gjyqtarit laik të paraparë e nenin 40. par. 3 të këtij Kodi bëhet para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Andaj, mos vendosja për këtë kërkesë nuk ka pas ndikim në marrjen e vendimit të drejt të gjykatës së shkallës së parë.

Në anën tjetër, propozimet të cilat ceken në kërkesë e të cilat gjykata nuk i ka aprovuar, jo vetëm se kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, e për këtë bazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konform nenit 432. par. 2. të KPPK nuk lejohet, por janë marrë në konsideratë nga gjykata e shkallës së parë

Kështu, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 26.07.2012, del se mbrojtësi i të dënuarit të gjitha këto propozime i ka paraqitur në shqyrtimin gjyqësor dhe trupi gjykues po në atë procesverbal ka marrë aktvendim me të cilin propozimet janë refuzuar, me arsyetim se gjykata ka administruar prova të mjaftueshme për ndriçimin e çështjes ndërsa me provat e propozuara vetëm do të përsëriteshin provat ekzistuese dhe do të zvarritej procedura penale. Andaj, gjykata propozimet i ka mare në konsideratë dhe ka dhënë arsyetim ligjor për refuzimin e tyre, ashtu që Gjykata Supreme gjenë se nuk janë të bazuara pretendimet në kërkesë se ato janë neglizhuar dhe është bërë shkelja e dispozitave të procedurës penale.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u konsiderua si e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi”.

24. Më 21 janar 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin PN. nr. 16/2014, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kp. nr. 240/2013, si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës dhe të nenit 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, me arsyetim se:
- Nuk është respektuar parimi i barazisë së armëve, sepse gjykatat e rregullta i kanë aprovuar propozimet e organit të akuzës për nxjerrjen dhe administrimin e provave, ndërsa pretendohet se parashtruesit të kërkesës arbitrarisht i është mohuar kjo e drejtë;
 - duke i refuzuar propozimet e parashtruesit të kërkesës për nxjerrjen e provave, gjykatat e rregullta e kanë shkelur prezumimin e pafajësisë, kanë paragjykuar fajësinë e të akuzuarit, dhe e kanë kufizuar dhe e kanë pamundësuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për t'u mbrojtur nga akuzat.
26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se propozimi i tij që anëtari i personelit mjekësor të dëgjohej si dëshmitar i cili e kishte marrë të dëmtuarin në vendin e ngjarjes, ka pasur rëndësi, sepse do të vërtetohej:
- nëse i dëmtuari ka pasur në brezin e tij armë zjarri ose armë të ftohtë apo mjet tjetër, të dukshëm, brenda në pallton e tij pasi që është frikësuar i akuzuari;
 - deklarata e të dëmtuarit L. G. se F. D. (i biri i parashtruesit të kërkesës) e kishte gjuajtur me gurë, pas plagosjes së tij nga parashtruesi i kërkesës;

- sjellja e të akuzuarit pas veprimeve të tij që dihet se ai kishte dashur të vrasë veten;
 - veprimet e anëtarëve të familjes së të akuzuarit, posaçërisht të F. H. dhe D. H., të palës së dëmtuar, dëshmitarit dhe posaçërisht pendimi i menjëhershëm i parashtruesit të kërkesës.
27. Parashtruesi pretendon se dëgjimi i ekspertit të mjekësisë ligjore ishte i nevojshëm për shkak të faktit se eksperti i mjekësisë ligjore, F. B., e kishte kryer ekspertizën pa e parë fare palën e dëmtuar, L. G., dhe se ka qenë i domosdoshëm dëgjimi i ekspertit, sepse: *“ekspertiza nuk e bën përshkrimin e plotë të plagëve dhe në ekspertizë thuhet se lidhur me pasojat e përhershme nga këto dëmtime është e nevojshme të pritet deri në përfundimin e mjekimit”*.
28. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që:
- a) *“Të lejojë masën e përkohshme deri në vendimin e Gjykatës për pranueshmerinë e kërkesës;*
 - b) *Të suspendojë menjëherë zbatimin e Vendimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 113/2013 të 29 shtatorit 2013, dhe urdhrin ED. nr. 201/13 për ekzekutim të dënimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 248/12 të datës 03 shtator 2012 si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 1327/12 të 3 prillit 2013.*
 - c) *Ta deklarojë kërkesën të pranueshme.*
 - d) *Në përputhje me rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës rregulli 39 të urdhëroj mbajtjen e seancës dëgjimore.*
 - e) *Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 111/2013 të 24 shtatorit 2013, Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 248/12 të 3 shtatorit 2012 si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. Nr. 1327/12 të 3 prillit 2013”*.
29. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës ka deklaruar se në rastet e ngjashme, Gjykata ka nxjerrë aktvendime për pranueshmëri dhe është thirrur në praktikën gjyqësore të Gjykatës, posaçërisht rastin KI78/12, parashtrues *Bajrush Xhemajli*, Aktgjykim i 24 janarit 2013.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

33. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, se ai i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, siç parashihen me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe se kërkesa është parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

34. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar”.

35. Gjykata vëren se në rastin e tanishëm, parashtruesi i kërkesës ka ngritur shumë çështje lidhur me procedurat para gjykatës së shkallës së parë dhe të Apelit; sidoqoftë, parashtruesi kishte kërkuar nga Gjykata që të krahasojë kërkesën e tij me rastin KI78/12, parashtrues i kërkesës *Bajrush Xhemajli*, aktgjykim i nxjerrë nga kjo Gjykatë, më 24 janar 2013 (në tekstin mëtejshëm: rasti Xhemajli).

36. Gjykata vëren se ka disa aspekte kyçe, në të cilat kërkesa e tanishme dallon me rastin Xhemajli. Në këtë rast, Gjykata vëren se: i) parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se dëgjimi i dëshmitarëve të caktuar dhe vlerësimi i provave të caktuara ishte absolutisht i nevojshëm për të konstatuar të vërtetën, ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se dështimi për të dëgjuar disa dëshmitarë ka paragykuar të drejtat e mbrojtjes dhe ndershmërinë e procedurës në tërësi, iii) parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se raporti i ekspertit ishte absolutisht i nevojshëm për shkak se ai përbënte bazë dominuese për dënimin e parashtruesit të kërkesës, dhe iv) parashtruesi nuk ka dëshmuar që ekspertët e përfshirë në rastin e parashtruesit janë pajtuar se ata nuk i kanë vlerësuar të gjithë faktorët e përfshirë.

37. Sa i përket paraqitjes së provave të caktuara dhe dëgjimit të dëshmitarëve të caktuar të propozuar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata konsideron se Gjykata e Qarkut ka dhënë përgjigje të gjerë dhe të plotë pothuajse në të gjitha çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës, e pasuar nga Gjykata Supreme, e cila i mbështeti arsyet e dhëna nga Gjykata e Qarkut.

38. Gjykata vëren se në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë vlerësuar të gjitha provat e nxjerra para tyre (aktakuza e prokurorit, skicat, fotografitë, raportet balistike dhe mjekësore, dëshmitë nga dëshmitarët okularë etj) dhe për më tepër, parashtruesi i kërkesës është lejuar të komentojë të gjitha provat dhe i është dhënë mundësia për të mbrojtur rastin e tij para gjykatave të rregullta.
39. Duke marrë parasysh procedurat para gjykatave të rregullta, Gjykata konsideron se kërkesa për gjykim të drejtë, e sanksionuar në nenin 6 të Konventës, është se ajo mbulon procedurat në tërësi, dhe çështja nëse një person ka pasur një gjykim të drejtë shikohet me anë të analizës kumulative të të gjitha fazave, jo vetëm të një incidenti të veçantë ose të një mangësie procedurale, si rezultat, mangësitë në një fazë mund të korrigjohen në një fazë të mëvonshme (shih rastin *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr 9562/81, 9818/82, GJEDNJ, Aktgjykimi i 2 marsit 1987, paragrafi 55).
40. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta, përveç vlerësimit të të gjitha dëshmive të paraqitura para tyre dhe në interes të drejtësisë, kishin marrë parasysh rrethanat lehtësuese, si shëndetin e parashtruesit, moshën relativisht të vjetër, pendimin dhe faktin se ai nuk është shkelës serik i ligjit para se t'i shqiptohej dënimi me burgim.
41. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve. Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih, *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65; gjithashtu *mutatis mutandis*, shih rastin KI-86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
42. Përveç kësaj, kërkesa nuk tregon që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave t'i vlerësojnë provat që i kanë para tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (shih *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).
43. Fakti që parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

44. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës dhe të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me Konventë.
45. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.
46. Sa i përket kërkesës së parashtruesit të kërkesës për mbajtjen e një seance dëgjimore, Gjykata i referohet rregullit 39 (1) të Rregullores së punës:

“Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës...”

47. Prandaj, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për të mbajtur seancë dëgjimore refuzohet.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

48. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për vendosjen e masës së përkohshme, Gjykata i referohet nenit 116.2 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme”.

49. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 27 të Ligjit, i cili parasheh:

“Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik”.

50. Gjykata konsideron se një kërkesë e tillë nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me nenin 116.2 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit, që do ta shtynte Gjykatën të vendosë masën e përkohshme; prandaj kërkesa për të vendosur masën e përkohshme refuzohet.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 dhe 116.1 të Kushtetutës, neneve 47 dhe 27 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullat 54 dhe 56 të Rregullores së punës, më 31 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. TA REFUZOJË kërkesën për mbajtjen e një seance dëgjimore;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- V. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Prof. dr. Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

